



UNMIK/REG/2005/27
17 maj 2005

RREGULLORE NR. 2005/27

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR NJË NDRYSHIM TË LIGJIT NR. 2003/2 DHE
2003/21 MBI MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË TË
MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 8.1, 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 25 shkurt 2005 lidhur me Ligjin mbi një ndryshim të Ligjit nr. 2003/2 dhe 2003/21 mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 shkurt 2005,

Duke konstatuar se dispozitat e Ligjit nuk i cenojnë kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo pushtetin e tij të rezervuar dhe përgjegjësitë sipas Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, e posëçerisht nenin 8.1 (c) të saj,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi ndryshimin e Ligjit nr. 2003/2 dhe 2003/21 mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (Ligji nr. 02/L-16), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në ditën e nënshkrimit, me kusht që:

- (a) Termi “Ligji mbi përvetësimet” kudo që është përdor në Ligj të kuptohet dhe interpretohet si “Legjislacion mbi përvetësimet” në pajtim me paragrafët B(b) dhe (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/17 mbi shpalljen e Ligjit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe

- (b) Në fillim të nenit të ndryshuar 21.1 termi “i miratuar” të zëvendësohet me termin “i aprovuar”.

Ndryshimi nën pikën (b) do të paraqitet në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 17 maj 2005

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm